



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1301/1 prot.

Tiranë, më 03.10. 2022

Lënda: Njoftim dhe kërkesë për informacion

TOP CHANNEL SH.A.

Rruga "17 Nëntori", Nr. 20, Mëzez Kodër, Komuna Kashar,
TIRANË

Z. Olsi JAZEXHI

Mbështetur në nenin 32/1/c të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke marrë indicien nga informacioni i transmetuar në televizionin Top-Channel¹, me urdhërin Nr. 151, datë 30.09.2022, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes në lidhje me shprehjet e përdorura nga shtetasi Olsi Jazexhi në emisionin "Ftesë në 5" të datës 29.09.2022, transmetuar në televizionin Top-Channel.

Referuar emisionit të sipërcituar, shtetasi Olsi Jazexhi, ka qënë i ftuar në Top Channel, në emisionin "Ftesë në 5", të moderatores Bieta Sulo, të datës 29.09.2022. Tema e emisionit², lidhej me: "Pas kërkesës për ligjërimin e poligjinisë nga bashkëshortja e tij, avokatja Migena Balla, Olsi Jazexhi përgjigjet publikisht rreth çështjes që u kthye në pak minuta lajm në të gjitha mediat e shkruara dhe jo vetëm".

Gjatë emisionit, në pjesën e dytë të tij, z. Olsi Jazexhi i është drejtuar znj. Zhaklin Lekatari (e ftuar në emision), duke përdorur shprehje diskriminuese dhe denigruese për shkak të gjinisë.

Gjatë diskutimit të zhvilluar në emisionin "Ftesë në 5" të datës 29.09.2022, rezulton se z. Jazexhi ndër të tjera është shprehur se: "Ti moj budallaqë, moj...", "...një copë injorante, që ka një blog

¹ <https://top-channel.tv/video/ftese-ne-5-olsi-jazexhi-ofendon-publikisht-zhakun-bieta-i-fik-mikrofonin-29-shtator-2022-pjesa-2/>

² Publikuar në faqen web të emisionit në Top-Channel: <https://top-channel.tv/video/ftese-ne-5-olsi-jazexhi-dhunon-publikisht-zhakundebati-degradon-ne-limite29-shtator-2022-pjesa-2/>

seksi, ajo duhet të bëjë filma pornografikë, jo të vijë të më ofendojë mua këtu.”, “Ik martohu gjej një burrë”...”.

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e gjuhës fyese dhe intolerancës ndaj një komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike. Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

Diskriminimi për shkak të gjinisë, është shkak i nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në të cilin në nenin 3/1, parashikohet se: “’Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Ligji 10221/2010 ka parashikuar në Nenin 7/1 “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Mbështetur në nenin 32, pika 2 “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”. Për faktet që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se : “Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim”, nuk lind nevoja për verifikim.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2 ku përcaktohet se: “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”³, si dhe në nënin 33,

³ Bazuar në nenin 33/13, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”: “Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë: a) personi fizik, nga 10 000 deri në 60 000 lekë; b) personi juridik nga 60 000 deri në 600 000 lekë; c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, nga 30 000 deri në 80 000 lekë; ç) personi, i cili ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkelje në bazë të këtij ligji, nga 30 000 deri në 80 000 lekë; d) personi fizik ose juridik, i cili kryen një ose më shumë nga format e

pika 7, ku parashikohet se: *“Me regjistrimin e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve pune nga dita që palët marrin njoftimin....”*, **kërkon që të jepni parashtrimet tuaja, si dhe informacionin dhe kopje të dokumentacionit si më poshtë:**

- Një kopje e plotë në CD, të emisionit *“Ftesë në 5”*, të transmetuar më datë 29.09.2022, ora 17:00, në televizionin Top Channel;
- Nga ana e televizionit Top Channel një adresë kontakti e z. Olsi Jazexhi (telefon/e-mail/adresë postare etj.);

Komisioneri do vlerësojë pozitivisht faktin, nëse nga ana z. Jazexhi dhe televizionit Top Channel, do të ndërmerreshin masa të menjëhershme lidhur me rregullimin e kësaj problematike, duke kërkuar ndjesë publike lidhur me gjuhën dhe shprehjet e përdorura ndaj znj. Zhaklin Lekatari, në emisionin *“Ftesë në 5”*, të transmetuar më datë 29.09.2022, ora 17:00, në televizionin Top Channel.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI
Robert Gajda
Robert GAJDA


rënda të diskriminimit, dyfishin e masës së gjobës së parashikuar përkatësisht në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 13, të nenit 33.”

